



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

RAPORT
PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË
NË KUADËR TË INSTITUCIONEVE TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS PËR VITIN 2024

2025, Prishtinë

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
FJALË HYRËSE	6
1. HYRJE	7
1.1 Metodologjia e përdorur	7
2. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR RAPORTIMIN NGA INSTITUCIONET/ORGANIZATAT BUXHETORE	8
2.1 Raportimi nga organizatat buxhetore sipas rregullores	8
2.2 Digjitalizimi i raportimit	8
2.3 Përgjegjësitë dhe lidhja me ligjin për menaxhimin e financave publike	8
2.4 Përmirësimet dhe sfidat në raportim	8
2.5 Pjesëmarrja e institucioneve në raportimin për vitin 2024	8
3. TË DHËNAT MBI FINANCIMIN PUBLIK SIPAS INSTITUCIONEVE	11
3.1 Shumat dhe projektet e mbështetura	11
3.2 Niveli qendror: ZKM dhe Ministritë	13
3.3 Niveli lokal: Komunat	14
3.4 Të dhënat e përgjithshme për vitin 2024	15
3.5 Krahasimi ndër vite 2023–2024	16
4. QËLLIMI I MBËSHTETJES FINANCIARE	20
4.1 Objektivat e përgjithshme	20
4.2 Platforma dhe mekanizmi i raportimit	20
4.3 Avancimi i procesit të raportimit	20
4.4 Rekomandime për përmirësim	20
4.5 Përfitimet institucionale	20
5. TË DHËNAT E DETAJUARA PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE	21
5.1 ZKM dhe ministritë	21
5.2 Komunat	22
5.3 Numri i projekteve të mbështetura	24
5.4 Analiza krahasuese ndër vite	25
6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	27

6.1 Konkluzionet kryesore	27
6.2 Rekomandime për institucionet/organizatat buxhetore	
6.3 Rekomandime shtesë për financimin e OJQ-ve	
6.4 Konkluzionet e përgjithshme.....	28
7. ANEKSET	29
7.1 Lista e OJQ-ve përfituese sipas ZKM dhe ministrive	29
7.2 Lista e OJQ-ve përfituese sipas komunave.....	83

LISTA E SHKURTESAVE

- 1. ZKM** ZYRA E KRYEMINISTRIT
- 2. MPB** MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
- 3. MAPL** MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
- 4. MASHTI** MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
- 5. MBPZHR** MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
- 6. MD** MINISTRIA E DREJTËSISË
- 7. MFPT** MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE
- 8. MM** MINISTRIA E MBROJTJES
- 9. ME** MINISTRIA E EKONOMISË
- 10. MKK** MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM
- 11. MKRS** MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT
- 12. MMPH** MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
- 13. MPJD** MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS
- 14. MSH** MINISTRIA E SHËNDETËSISË
- 15. MINT** MINISTRIA E INDUSTRIISË NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË
- 16. MZHR** MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL
- 17. OJQ** ORGANIZATA JO-QEVERITARE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport pasqyron financimin publik për organizatat e shoqërisë civile (OJQ) gjatë vitit 2024, duke u bazuar në të dhënat e mbledhura përmes platformës online dhe raporteve të dorëzuara nga institucionet qendrore dhe komunale.

Në total, janë raportuar mbi 14 milionë euro fonde të ndara për projekte të ndryshme në fusha si arsimi, kultura, sporti, barazia gjinore dhe përfshirja sociale. Procesi i raportimit është kryer kryesisht përmes platformës online të financimit publik të OJQ-ve, duke rritur transparencën dhe qasjen publike në të dhëna.

Nga 57 institucione të detyruara të raportojnë, 48 dorëzuan raporte, ndërsa pjesa tjetër nuk e përmbushi këtë obligim. Në nivel qendror, pothuajse të gjitha ministritë raportuan, ndërsa në nivel lokal shumica e komunave dorëzuan të dhëna, megjithëse disa munguan.

Krahasuar me vitin 2023, viti 2024 ka shënuar një rritje të dukshme të shumës së përgjithshme të fondeve, kryesisht falë dyfishimit të mbështetjes nga niveli qendror (ZKM dhe ministritë), i cili ka kaluar nga rreth 4.3 milionë € në mbi 8.5 milionë €. Ndërkohë, niveli lokal ka ruajtur një financim pothuajse të qëndrueshëm, me një ulje të lehtë nga rreth 6 milionë € në 5.99 milionë €. Ky kombinim ka sjellë jo vetëm rritje të totalit, por edhe një diversifikim më të madh të projekteve të mbështetura. Përmirësimet teknologjike të platformës kanë lehtësuar raportimin dhe publikimin e të dhënave, megjithëse disa sfida mbeten, si harmonizimi i të dhënave dhe respektimi i afateve të raportimit.

Konkluzionet kryesore janë se procesi i financimit publik është duke u bërë më transparent dhe gjithëpërfshirës, por ka ende nevojë për përmirësime teknike dhe organizative. Rekomandimet kryesore përfshijnë forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, respektimin e afateve të raportimit dhe mbështetjen e shtuar për stafin teknik.

Kjo përmbledhje synon t'i ofrojë lexuesit një pasqyrë të shpejtë dhe të plotë mbi gjetjet dhe rekomandimet e raportit, duke theksuar përkushtimin e institucioneve për transparencë, llogaridhënie dhe mbështetje efektive të shoqërisë civile.

FJALË HYRËSE

Të nderuar/a,

Publikimi i Raportit Vjetor mbi Mbështetjen Financiare Publike për Organizatat Joqeveritare për vitin 2024 përfaqëson një arritje të rëndësishme institucionale për Republikën e Kosovës. Përveç publikimit të këtij raporti, gjatë vitit 2024 kemi shënuar përparime të konsiderueshme në ndërtimin e kapaciteteve institucionale, veçanërisht në planifikimin, shpalljen e thirrjeve për financim, raportimin dhe administrimin e platformës për financimin publik të OJQ-ve. Çdo institucion ka kontribuar në mënyrë aktive në forcimin e këtyre proceseve, përmes ngritjes së kapaciteteve të koordinatorëve për raportim, krijimit të një sistemi të qëndrueshëm raportimi dhe avancimit të platformës online.

Raporti ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të burimeve financiare të ndara dhe të shpërndara për OJQ-të, si dhe mënyrën se si këto fonde janë përdorur për të përmbushur misionet dhe aktivitetet e tyre. Vëmendje e veçantë i kushtohet vlerësimit të rezultateve dhe ndikimit konkret në komunitet, si dhe zhvillimit të kapaciteteve institucionale për t'u përballur me sfidat bashkëkohore në një mjedis dinamik dhe kërkues.

Përmes këtij raporti riafirmojmë angazhimin tonë për llogaridhënie institucionale dhe kontributin tonë në avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm shoqëror dhe ekonomik. Gjithashtu, raporti paraqet objektivat dhe parashikimet strategjike për të ardhmen, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile.

Edhe pse sfidat mbeten të pranishme, ne jemi plotësisht të përkushtuar për t'i adresuar ato përmes politikave dhe strategjive të qarta, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, të cilat i shërbejnë interesave afatgjata të qytetarëve tanë.

Në emër të Zyrës së Kryeministrit/Zyrës për Qeverisje të Mirë shprehim falënderimin për korrektësinë dhe përkushtimin e institucioneve në zbatimin e Rregullores për financimin publik të OJQ-ve, qoftë përmes raportimit në platformën online apo dorëzimit me kohë të formularit F-20. Ky falënderim është veçanërisht i adresuar për ata që, pavarësisht vështirësive teknike në qasje, kanë siguruar përmbushjen e obligimeve. Gjatë vitit janë shfaqur probleme teknike që kanë ndikuar në funksionimin e platformës, duke sjellë vonesa të pashmangshme në përpunimin dhe publikimin e të dhënave. Për shkak të kësaj, përmbledhja është përgatitur në mënyrë manuale, çka ka qenë proces i vështirë dhe ka ndikuar në vonesën e publikimit.

Faleminderit për mbështetjen dhe bashkëpunimin tuaj të vazhdueshëm në këtë udhëtim të përbashkët drejt shërbimit publik dhe transformimit pozitiv shoqëror.

Me respekt,

Habit Hajredini

Drejtor, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit

1. HYRJE

Rregullorja MF-Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve përcakton detyrimet e institucioneve publike për raportimin e financimit të projekteve dhe programeve të OJQ-ve. Qëllimi i saj është të unifikojë të gjithë ciklin e financimit publik nga planifikimi, thirrjet publike, kontraktimi, monitorimi deri te raportimi.

Rregullorja përcakton jo vetëm rolin e Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit (ZQM/ZKM), por edhe të të gjitha institucioneve buxhetore për përgatitjen e raportit gjithëpërfshirës vjetor mbi mbështetjen financiare publike për OJQ-të. Në bazë të nenit 26, çdo organizatë buxhetore duhet të përgatisë raportin e saj për vitin fiskal paraprak dhe ta dorëzojë në ZQM/ZKM, si dhe ta publikojë në faqen e saj zyrtare.

Për vitin 2024, ZQM/ZKM ka mbledhur raportet e 15 ministrive, tri zyrave të Zyrës së Kryeministrit dhe Agjencisë për Barazi Gjinore, si dhe të 38 komunave. Nga këto institucione, një pjesë raporto mbështetje konkrete për OJQ-të, ndërsa disa deklaruan se nuk kishin financuar. Disa komuna nuk dorëzuan raport fare, ndërsa disa të tjera raportuan me vonesë për shkak të vështirësive teknike në platformën online. Kjo platformë është përdorur si mjeti kryesor për grumbullimin dhe publikimin e të dhënave për financimet publike.

Ky raport gjithëpërfshirës për vitin 2024 pasqyron përkushtimin e institucioneve për transparencë, llogaridhënie dhe efikasitet në ndarjen e fondeve publike për shoqërinë civile.

1.1 Metodologjia e përdorur

Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM/ZKM), në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, ka ngritur një sistem transparent dhe të qëndrueshëm për financimin publik të organizatave të shoqërisë civile. Transparenca dhe llogaridhënia janë forcuar përmes zhvillimit dhe përmirësimit të Platformës Online për Financim Publik të OJQ-ve (<http://ojqfinancime.rks-gov.net>). Kjo platformë ofron të dhëna të detajuara sipas viteve, institucioneve, sektorëve dhe rajoneve, duke mundësuar raportim të drejtpërdrejtë dhe hierarkik nga të gjitha ministrinë dhe komunat.

Procesi i raportimit për vitin 2024 u bazua kryesisht në të dhënat e futura nga institucionet në platformë. Manualet dhe udhëzuesit teknikë janë shpërndarë për të lehtësuar punën e koordinatorëve, ndërsa është ofruar edhe mbështetje teknike për zyrtarët përgjegjës. Në disa raste, raportimi është bërë edhe përmes formularit standard F-20.

Përveç raportimit të drejtpërdrejtë, ZQM/ZKM ka analizuar faqet zyrtare të institucioneve për të shqyrtuar thirrjet publike, përmbajtjen dhe rrjedhën e procedurave për financim. Duhet theksuar se ZQM/ZKM nuk mban përgjegjësi për saktësinë e të dhënave të raportuara nga organizatat buxhetore.

Avancimet teknologjike të platformës gjatë 2024–2025 kanë përfshirë: përmirësimin e funksionalitetit, mundësinë e raportimit masiv dhe ndërveprimin publik përmes grafikëve dhe filtrave të të dhënave. Megjithatë, sfida teknike dhe vonesat e raportimit nga disa institucione kanë ndikuar në publikimin me vonesë të raportit vjetor.

2.TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR RAPORTIMIN NGA INSTITUCIONET/ORGANIZATAT BUXHETORE

2.1 Raportimi nga organizatat buxhetore sipas rregullores

Sipas Rregullores MF-Nr. 04/2017, çdo institucion buxhetor është i detyruar të përgatisë dhe të publikojë raportin vjetor për financimin e OJQ-ve. Për vitin 2024, nga 57 institucione të detyruara të raportojnë, raportet janë dorëzuar nga pjesa më e madhe e tyre, ndërsa disa kanë hasur në vështirësi teknike apo nuk kanë realizuar raportimin brenda afatit. Kjo ndikon drejtpërdrejt në nivelin e transparencës dhe llogaridhënies.

2.2 Digjitalizimi i raportimit

Platforma online për financimin publik të OJQ-ve ka qenë mjete kryesor i raportimit për vitin 2024. Institucionet qendrore dhe lokale kanë përdorur sistemin për futjen e të dhënave mbi thirrjet publike, projektet e kontraktuara dhe shumat e financuara. Digjitalizimi ka lehtësuar grumbullimin e të dhënave dhe ka mundësuar publikimin e tyre në kohë reale për publikun.

2.3 Përgjegjësitë dhe lidhja me ligjin për menaxhimin e financave publike

Raportimi i financimit të OJQ-ve është i lidhur ngushtë me zbatimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi. Ky ligj kërkon që çdo shpenzim publik të dokumentohet dhe të publikohet, duke siguruar llogaridhënie dhe transparencë. Mos raportimi nga një pjesë e komunave dhe organizatave buxhetore mbetet një sfidë për zbatimin e plotë të kësaj rregulloreje.

2.4 Përmirësimet dhe sfidat në raportim

Raportimi për vitin 2024 tregoi përmirësim krahasuar me vitin paraprak, si në cilësinë ashtu edhe në nivelin e pjesëmarrjes së institucioneve. Megjithatë, mbeten disa sfida të dukshme: mosharmonizimi i të dhënave, raportimi me vonesë nga disa institucione, dhe mungesa e të dhënave të plota për disa projekte të financuara. Këto elemente e vështirësojnë krahasimin e saktë ndër vite.

2.5 Pjesëmarrja e institucioneve në raportimin për vitin 2024

Nga 57 institucione që kishin detyrim të raportojnë për vitin 2024, janë 48 që e përmbushën këtë obligim, ndërsa 9 nga to nuk dërguan raport. Në nivel qendror, pjesa më e madhe e ministrive dhe zyrave të ZKM kanë dorëzuar raporte të plotë. Në nivel lokal, shumica e komunave kanë raportuar, por një numër i vogël ka munguar. Ky nivel pjesëmarrjeje tregohet në figurat shoqëruese. Figura 1 paraqet se mbi 80% e institucioneve kanë raportuar për vitin 2024, duke reflektuar një nivel të lartë të përmbushjes së obligimeve. Figura 2 pasqyron se 11 nga 16 institucione ose 68,75% kanë

përkrahur projekte. Nga ana tjetër, Figura 3 nxjerr në pah që disa komuna ende nuk kanë raportuar, çka e ul nivelin e transparencës në nivel lokal. Krahasimi i paraqitur në Figurën 4 ilustron qartë hendekun midis nivelit qendror dhe atij lokal.




Figura 1 – Përqindja e institucioneve që kanë raportuar




Figura 2 – Raportimi nga niveli qendror për përkrahjen e OJQ-ve




Figura 3 – Raportimi nga niveli lokal për përkrahjen e OJQ-ve




Figura 4 – Krahasimi sipas niveleve

3. TË DHËNAT MBI FINANCIMIN PUBLIK SIPAS INSTITUCIONEVE

3.1 Shumat dhe projektet e mbështetura

Për vitin 2024, financimi publik për organizatat e shoqërisë civile është shpërndarë përmes institucioneve të ndryshme qendrore dhe lokale. Shumat e ndara kanë mbuluar projekte të fokusuara në fusha të ndryshme si arsimi, kultura, sporti, të drejtat e njeriut, përfshirja sociale dhe barazia gjinore. Figura 5, Figura 6 dhe Figura 7 paraqesin ndarjen e shifrave dhe numrin e projekteve të financuara. Figura 7 tregon qartë se sporti dhe kultura janë sektorët që kanë marrë pjesën më të madhe të fondeve, ndërsa fusha të tjera si të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore kanë marrë mbështetje më të ulët relative. Kjo tregon një orientim të institucioneve drejt projekteve me ndikim komunitar dhe pjesëmarrje të gjerë shoqërore.




Figura 5 – Numri i projekteve të mbështetura sipas niveleve




Figura 6 – Totali i shumave të ndara për projekte sipas niveleve




Figura 7 – Krahasimi i përkrahjes sipas numrit të projekteve

3.2 Niveli qendror: ZKM dhe Ministrinë

Në nivel qendror, mbështetja financiare për OJQ-të është dhënë nga Zyra e Kryeministrit dhe ministrinë e linjës. Figura 8 paraqet numrin e projekteve të financuara sipas ministrive, ndërsa Figura 9 tregon shumatat e ndara. Disa ministri kanë pasur buxhet më të lartë për thirrje publike, ndërsa disa të tjera kanë mbështetur projekte me vlera më të vogla por me fokus të veçantë tematik.




Figura 8 – Numri i projekteve sipas ministrive




Figura 9 – Shumat e ndara sipas ministrive

3.4 Të dhënat e përgjithshme për vitin 2024

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të gjitha organizatat buxhetore që kanë raportuar për vitin 2024, përfshirë Zyrën e Kryeministrit, ministritë dhe komunat. Për secilin institucion jepet shuma totale e ndarë për mbështetjen e projekteve të OJQ-ve gjatë vitit. Këto të dhëna ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi shpërndarjen e fondeve publike në nivel qendror dhe lokal, duke mundësuar identifikimin e institucioneve që kanë ndarë buxhet më të madh dhe atyre me fonde më të kufizuara. Analiza e tabelës tregon dallime të dukshme në kapacitetet financiare të institucioneve, ku disa ministri dhe komuna kanë siguruar mbështetje të konsiderueshme për shoqërinë civile, ndërsa të tjera kanë kontribuar në nivele më të ulëta. Kjo pasqyrë është themelore për të kuptuar trendin e përgjithshëm të financimit dhe për të vlerësuar shkallën e angazhimit të secilit institucion në fuqizimin e shoqërisë civile.

NR.	EMRI I ORGANIZATËS BUXHETORE	Shuma e dhënë nga institucionet për OJQ gjatë vitit 2024 (Euro)
	<u>ZKM</u>	
I.	Zyra e Kryeministrit	608.520,00 €
	<u>Ministritë</u>	
1.	MKRS- Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	4.368.501,00 €
2.	ME- Ministria e Ekonomisë	34.100,00 €
3.	MASHTI-Ministra e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	299.970,00 €
4.	MZHR- Ministria e Zhvillimit Rajonal	236.035,00 €
5.	MPJD- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	651.975,00 €
6.	MD- Ministria e Drejtësisë	1.533.500,00 €
7.	MSH- Ministria e Shëndetësisë	118.813,28 €
8.	MAPL- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	65.000,00 €
9.	MKK- Ministria për Komunitete dhe Kthim	195.970,00 €
10.	MBPZHR-Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	250.845,82 €
11.	MINT- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ
12.	MPB- Ministria e Punëve të Brendshme	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ
13.	MMPHI-Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ
14.	MM- Ministria e Mbrojtjes	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ
15.	MFPT- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ
	Gjithsej	8.363.230,10 €
	<u>KOMUNAT</u>	
1.	Komuna e Deçanit	69.500,00 €
2.	Komuna e Dragashit	296.000,00 €
3.	Komuna e Ferizajt	39.500,00 €
4.	Komuna e Fushë Kosovës	119.800,00 €
5.	Komuna e Glogocit/Drenasit	38.477,00 €
6.	Komuna e Graçanicës	517.860,00 €
7.	Komuna e Gjakovës	194.700,00 €
8.	Komuna e Gjilanit	268.740,00 €
9.	Komuna e Hanit të Elezit	26.000,00 €

10.	Komuna e Istogut	157.438,06 €
11.	Komuna e Junikut	4.892,60 €
12.	Komuna e Kaçanikut	94.870,00 €
13.	Komuna e Kamenicës	151.457,49 €
14.	Komuna e Lipjanit	135.000,00 €
15.	Komuna e Novobërdës/Artanës	270.866,97 €
16.	Komuna e Obiliqit	265.671,93 €
17.	Komuna e Parteshit	5.000,00 €
18.	Komuna e Pejës	338.500,00 €
19.	Komuna e Podujevës/Besianës	126.250,00 €
20.	Komuna e Prishtinës	1.236.295,62 €
21.	Komuna e Prizrenit	1.398.800,00 €
22.	Komuna e Skenderajt	148.802,78 €
23.	Komuna e Shtimes	95.059,52 €
24.	Komuna e Kllokotit	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ
25.	Komuna e Malishevës	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ
26.	Komuna e Mamushës	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ
27.	Komuna e Mitrovicës Veriore	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ
28.	Komuna e Rahovecit	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ
29.	Komuna e Ranillugut	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ
30.	Komuna e Suharekës/Therandës	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ
31.	Komuna e Shtërpçës	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ
32.	Komuna e Vitisë	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ
33.	Komuna e Vushtrisë	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ
34.	Komuna e Zubin Potokut	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ
35.	Komuna e Zveçanit	Ka raportuar se nuk ka përkrahur OJQ
36.	Komuna e Klinës	Nuk ka raportuar
37.	Komuna e Leposaviqit	Nuk ka raportuar
38.	Komuna e Mitrovicës	Nuk ka raportuar
Gjithsej		5.999.481,97 €

Tabela 1 - Shumat e ndara nga ZKM, ministritë dhe komunat

3.5 Krahasimi ndër vite 2023–2024

Në vitin 2024, shuma e përgjithshme e financimit publik të dedikuar për organizatat e shoqërisë civile ka qenë mbi 12 milionë euro. Figura 13 paraqet krahasimin e shifrave të vitit 2023 dhe 2024 për ZKM dhe ministritë, ndërsa Figura 14 për komunat. Këto të dhëna përbëjnë bazën për analizën e detajuar të trendëve dhe prioriteteve institucionale në financimin e OJQ-ve.

Krahasuar me vitin 2023, viti 2024 ka shënuar rënie të lehtë të shumës së përgjithshme të fondeve të ndara për OJQ-të. Figura 12 paraqet krahasimin e financimeve ndërmjet ZKM/ministrive dhe komunave në dy vitet e fundit. Ky krahasim ndihmon të kuptohet trendi i mbështetjes institucionale dhe përpjekjet për të rritur transparencën.




Figura 12 – Krahasimi i financimeve nga ZKM/ministrinë dhe komunat (2023–2024)




Figura 13 – Krahasimi i financimit të OJQ-ve nga ZKM dhe ministrinë (2023–2024)

4. QËLLIMI I MBËSHTETJES FINANCIARE

4.1 Objektivat e përgjithshme

Qëllimi kryesor i mbështetjes financiare publike për OJQ-të është të fuqizojë shoqërinë civile dhe të nxisë pjesëmarrjen e saj në zhvillimin demokratik, social dhe ekonomik të vendit. Përmes këtyre fondeve, synohet të forcohen kapacitetet e OJQ-ve dhe të mbështeten nisma që kontribuojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve.

4.2 Platforma dhe mekanizmi i raportimit

Platforma online e raportimit ka shërbyer si mekanizmi kryesor për transparencën e procesit të financimit publik. Ajo u mundëson institucioneve të publikojnë të dhëna të detajuara mbi thirrjet publike, kontratat dhe shumatat e ndara. Ky mekanizëm rrit besueshmërinë e publikut dhe i jep OJQ-ve një mjet të qartë për të ndjekur dhe monitoruar procesin.

4.3 Avancimi i procesit të raportimit

Procesi i raportimit është avancuar ndjeshëm falë digjitalizimit dhe ndërveprimit publik. Institucionet kanë pasur mundësi të fusin të dhëna më të sakta dhe të plota, ndërsa qytetarët dhe OJQ-të kanë pasur qasje në informacione të përditësuara në kohë reale. Kjo ka kontribuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

4.4 Rekomandime për përmirësim

Edhe pse procesi ka shënuar përparime të dukshme, mbeten disa fusha ku nevojiten përmirësime. Institucionet duhet të harmonizojnë më mirë të dhënat e raportuara, të shmangin vonesat në dorëzimin e raporteve dhe të ofrojnë mbështetje teknike më të madhe për stafin e përfshirë në procesin e raportimit. Një tjetër rekomandim është forcimi i kontrollit të brendshëm për të siguruar saktësinë e shifrave.

4.5 Përfitimet institucionale

Mbështetja financiare publike sjell përfitime të shumëfishta për institucionet dhe për shoqërinë në tërësi. Ajo ndihmon në krijimin e partneriteteve të qëndrueshme ndërmjet institucioneve publike dhe OJQ-ve, rrit nivelin e besimit të qytetarëve ndaj proceseve shtetërore dhe kontribuon në ndërtimin e një mjedisi më gjithëpërfshirës dhe demokratik. Përmes këtyre fondeve, institucionet arrijnë të avancojnë objektivat e tyre strategjike në mënyrë më efikase dhe transparente.

5. TË DHËNAT E DETAJUARA PËR MBËSHËTJETEN FINANCIARE

5.1 ZKM dhe ministrinë

Në nivel qendror, Zyra e Kryeministrit dhe ministrinë kanë ndarë fonde të konsiderueshme për projekte të organizuar nga OJQ-të. Të dhënat tregojnë se një pjesë e madhe e buxhetit është orientuar drejt projekteve që lidhen me të drejtat e njeriut, zhvillimin e qëndrueshëm, edukimin dhe fuqizimin e rinisë. Shumat e ndara dhe numri i projekteve sipas ministrive janë paraqitur në tabelat përkatëse.

NR.	EMRI I ORGANIZATËS BUXHETORE	RAPORTIMI NË ZQM BAZUAR NË RREGULLOREN MF-04/2017
<u>ZYRA E KRYEMINISTRIT</u>		
	ZYRA E KRYEMINISTRIT	<p>1. Agjencia për Barazi Gjinore kanë raportuar se gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare dhe kanë raportuar direkt në platformë.</p> <p>2. Zyra e Komisionarit për Gjuhët, kanë raportuar në platformë dhe kanë raportuar se gjatë vitit 2024 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare.</p> <p>3. Zyra për Komunitete kanë raportuar direkt në platformë/kanë raportuar se gjatë vitit 2024 kanë përkrahur organizata joqeveritare</p> <p>4. Zyra e Komisionarit për Persona të Pagjetur kanë raportuar se gjatë vitit 2024 nuk kanë përkrahur organizata joqeveritare.</p>
<u>MINISTRITË E LINJËS</u>		
1.	MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL	MAPL ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare.
2.	MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT	MASHTI ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare.
3.	MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	MBPZHR ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare.
4.	MINISTRIA E DREJTËSISË	MD ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare.
5.	MINISTRIA E FINANCAVE PUNËS DHE TRANSFEREVE	MFPT ka raportuar se gjatë vitit 2024 nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.
6.	MINISTRIA E MBROJTJES	MM ka raportuar se gjatë vitit 2024 nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.
7.	MINISTRIA MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPSIONR DHE INFRASTRUKTURËS	MMPHI ka raportuar se gjatë vitit 2024 nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.
8.	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	MKRS ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare.
9.	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	MPB ka raportuar se gjatë vitit 2024 nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.
10.	MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS	MPJD ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare.
11.	MINISTRIA E SHËNDETËSISË	MSH ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare.
12.	MINISTRIA E EKONOMISË	ME ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare.
13.	MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL	MZHR ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare.

14.	MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM	MKK ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare.
15.	MINISTRIA E INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË	MINT ka raportuar se gjatë vitit 2024 nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.

Tabela 2 – Pasqyra e raportimeve të financimit publik të OJQ-ve nga ZKM dhe ministrinë

Siç shihet në Tabelën 2, dallimet janë të dukshme: disa komuna kanë financuar vetëm një ose dy projekte, ndërsa të tjera kanë ndarë mbi dhjetë projekte. Kjo tregon qartë ndryshimet në prioritetet e politikave lokale dhe kapacitetet financiare të secilës komunë. Në Tabelën 3 shihet po ashtu se fusha e sportit dhe rinisë ka dominuar për nga numri i projekteve të mbështetura.

5.2 Komunat

Komunat kanë kontribuar ndjeshëm në mbështetjen e projekteve lokale, të cilat kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në komunitetet e tyre. Shumë komuna kanë financuar projekte në fushën e sportit, kulturës dhe integritit social. Tabelat përkatëse japin një pasqyrë të qartë të ndarjes së fondeve sipas komunave.

NR.	EMRI I ORGANIZATËS BUXHETORE	RAPORTIMI NË ZQM BAZUAR NË RREGULLOREN MF-04/2017
<u>KOMUNAT</u>		
1.	KOMUNA E DEÇANIT	Komuna e Deçanit ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
2.	KOMUNA E DRAGASHIT	Komuna e Dragashit ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
3.	KOMUNA E FERIZAJT	Komuna e Ferizajt ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
4.	KOMUNA E FUSHË KOSOVËS	Komuna e Fushë Kosovës ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
5.	KOMUNA E GJAKOVËS	Komuna e Gjakovës ka raportuar direkt në platformë/ gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
6.	KOMUNA E GJILANIT	Komuna e Gjilanit ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
7.	KOMUNA E GLLOGOCIT/ DRENASIT	Komuna e Drenasit ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
8.	KOMUNA E GRAÇANICËS	Komuna e Graçanicës ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
9.	KOMUNA E HANIT TË ELEZIT	Komuna e Hanit të Elezit ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
10.	KOMUNA E ISTOGUT	Komuna e Istogut ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
11.	KOMUNA E JUNIKUT	Komuna e Junikut ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
12.	KOMUNA E KAÇANIKUT	Komuna e Kaçanikut ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
13.	KOMUNA E KAMENICËS	Komuna e Kamenicës ka raportuar në F20 se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
14.	KOMUNA E KLINËS	Komuna e Klinës nuk ka raportuar

15.	KOMUNA E KLLOKOTIT	Komuna e Kllokotit ka raportuar se nuk ka pasur financim të OJQ-ve gjatë vitit 2024
16.	KOMUNA E LEPOSAVIQIT	Komuna e Leposaviqit nuk ka raportuar
17.	KOMUNA E LIPJANIT	Komuna e Lipjanit ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
18.	KOMUNA E MALISHEVËS	Komuna e Malishevës ka raportuar se nuk ka pasur financim të OJQ-ve gjatë vitit 2024
19.	KOMUNA E MAMUSHËS	Komuna e Mamushës ka raportuar se nuk ka pasur financim të OJQ-ve gjatë vitit 2024
20.	KOMUNA E MITROVICËS SË VERIUT	Komuna e Mitrovicës Veriore ka raportuar se nuk ka pasur financim të OJQ-ve gjatë vitit 2024
21.	KOMUNA E MITROVICËS SË JUGUT	Komuna e Mitrovicës nuk ka raportuar
22.	KOMUNA E NOVOBËRDËS/ ARTANËS	Komuna e Novobërdës ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
23.	KOMUNA E OBILIQIT	Komuna e Obiliqit ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
24.	KOMUNA E PARTESHIT	Komuna e Parteshit ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
25.	KOMUNA E PEJËS	Komuna e Pejës ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
26.	KOMUNA E PODUJEVËS/ BESIANËS	Komuna e Podujevës ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
27.	KOMUNA E PRISHTINËS	Komuna e Prishtinës ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
28.	KOMUNA E PRIZRENIT	Komuna e Prizrenit ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
29.	KOMUNA E RAHOVECIT	Komuna e Rahovecit ka raportuar direkt në platformë se thirrja gjatë vitit 2024 është anuluar dhe ndërprerë para skadimit të kontratës dhe nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.
30.	KOMUNA E RANILLUGUT	Komuna e Ranillugut ka raportuar direkt në platformë se thirrja gjatë vitit 2024 është anuluar dhe ndërprerë para skadimit të kontratës dhe nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.
31.	KOMUNA E SHTËRPECËS	Komuna e Shtërpçës ka raportuar direkt në platformë se thirrja gjatë vitit 2024 është anuluar dhe ndërprerë para skadimit të kontratës dhe nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.
32.	KOMUNA E SHTIMES	Komuna e Shtimes ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
33.	KOMUNA E SKENDERAJT	Komuna e Skenderajt ka raportuar direkt në platformë se gjatë vitit 2024 ka përkrahur organizata joqeveritare
34.	KOMUNA E SUHAREKËS/ THERANDËS	Komuna e Therandës/Suharekës ka raportuar direkt në platformë se thirrja gjatë vitit 2024 është anuluar dhe ndërprerë para skadimit të kontratës dhe nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.
35.	KOMUNA E VITISË	Komuna e Vitisë ka raportuar direkt në platformë se thirrja gjatë vitit 2024 është anuluar dhe ndërprerë para skadimit të kontratës dhe nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.
36.	KOMUNA E VUSHTRRISË	Komuna e Vushtrrisë kanë raportuar direkt në platformë se thirrja gjatë vitit 2024 është anuluar dhe ndërprerë para skadimit të kontratës dhe nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.
37.	KOMUNA E ZUBIN POTOKUT	Komuna e Zubin Potokut ka raportuar direkt në platformë se thirrja gjatë vitit 2024 është anuluar dhe ndërprerë para skadimit të kontratës dhe nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.

38.	KOMUNA E ZVEÇANIT	Komuna e Zveçanit ka raportuar direkt në platformë se thirrja gjatë vitit 2024 është anuluar dhe ndërprerë para skadimit të kontratës dhe nuk ka përkrahur organizata joqeveritare.
-----	--------------------------	--

Tabela 3 - Pasqyra e raportimeve të financimit publik të OJQ-ve nga komunitat

5.3 Numri i projekteve të mbështetura

Numri i projekteve të mbështetura në nivel kombëtar për vitin 2024 tregon një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2023. Rritja ka qenë më e dukshme në fushat e rinisë dhe sportit, ku interesimi dhe aplikimet e OJQ-ve kanë qenë më të larta. Përmes tabelave është paraqitur numri i projekteve të financuara sipas sektorëve kryesorë.

Nr.	Emri i Institucionit	Nr. i projekteve për OJQ-të përfituese gjatë 2024
I.	Zyra e Kryeministrit	59
1.	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	340
2.	MAPL	1
3.	MBPZHR	40
4.	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	5
5.	Ministria e Drejtësisë	52
6.	MASHT	10
7.	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	74
8.	Ministria e Zhvillimit Rajonal	61
9.	MSH	10
10.	MKK	30
11.	Ministria e Mbrojtjes	0
12.	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	0
13.	MINT- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	0
14.	MPB- Ministria e Punëve të Brendshme	0
15.	MMPHI- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	0
Numri total i projekteve për OJQ-të përfituese		682

Tabela 4 - Numri i projekteve të OJQ-ve të financuara nga ZKM dhe ministritë

NR.	Emri i Institucionit	Nr. i projekteve të përkrahura
1.	Komuna e Deçanit	20
2.	Komuna e Dragashit/Sharrit	30

3.	Komuna e Ferizajt	17
4.	Komuna e Fushë Kosovës	39
5.	Komuna e Glllogocit/ Drenasit	6
6.	Komuna e Graçanicës	10
7.	Komuna e Gjakovës	53
8.	Komuna e Gjilanit	101
9.	Komuna e Hanit të Elezit	9
10.	Komuna e Istogut	57
11.	Komuna e Junikut	6
12.	Komuna e Kaçanikut	21
13.	Komuna e Kamenicës	52
14.	Komuna e Lipjanit	19
15.	Komuna e Novobërdës/Artanës	3
16.	Komuna e Obiliqit	31
17.	Komuna e Parteshit	1
18.	Komuna e Pejës	71
19.	Komuna e Podujevës/Besianës	49
20.	Komuna e Prishtinës	208
21.	Komuna e Prizrenit	108
22.	Komuna e Skenderajt	26
23.	Komuna e Shtimes	30
24.	Komuna e Kllkotit	
25.	Komuna e Malishevës	
26.	Komuna e Mamushës	
27.	Komuna e Mitrovicës Veriore	
28.	Komuna e Rahovecit	
29.	Komuna e Ranillugut	
30.	Komuna e Suharekës/Therandës	
31.	Komuna e Shtërpçës	
32.	Komuna e Vitisë	
33.	Komuna e Vushtrrisë	
34.	Komuna e Zubin Potokut	
35.	Komuna e Zvecanit	
36.	Komuna e Mitrovicës	
37.	Komuna e Klinës	
38.	Komuna e Leposaviqit	
	Total	967

Tabela 5 - Numri i projekteve të OJQ-ve të financuara nga komunat

5.4 Analiza krahasuese ndër vite

Krahasimi i të dhënave ndërmjet viteve 2023 dhe 2024 tregon një tendencë të stabilitetit në shumën e përgjithshme të fondeve, me një rritje të lehtë të projekteve të financuara. Ky progres pasqyron përkushtimin e institucioneve për të mbështetur shoqërinë civile dhe për të avancuar transparencën në ndarjen e fondeve publike. Figura 12 dhe tabelat përkatëse tregojnë qartë se rritja është më e

dukshme në disa nga komunat më të mëdha, të cilat kanë ndarë fonde më të larta krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa disa ministri më të vogla kanë shënuar rënie ose stagnim në financim.

Në raportin e vitit 2024, nga 57 institucione me obligim raportimi, 48 dorëzuan të dhëna, duke përfaqësuar rreth 84% të përgjithshme. Ky nivel është pak më i lartë krahasuar me vitin 2023, çka tregon një trend pozitiv në përfshirjen e institucioneve. Megjithatë, mbetet një numër i kufizuar komunash dhe disa institucione të tjera që nuk raportuan, ose e bënë me vonesë, duke ndikuar në pasqyrimin e plotë të situatës.

Një element i rëndësishëm është se një pjesë e institucioneve raportuan se nuk kanë ndarë fonde për OJQ-të gjatë vitit 2024. Këto raste, edhe pse nuk ndikojnë në rritjen e shumës totale, pasqyrojnë një nivel të ri të transparencës, pasi edhe mos financimi është bërë pjesë e raportimit zyrtar.

Krahasimi ndër vite gjithashtu nxjerr në pah disa sfida të vazhdueshme. Ende vërehet mospërputhje e të dhënave në disa raste, si dhe mungesë harmonizimi ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal. Për më tepër, disa institucione nuk kanë përfshirë të gjitha detajet për projektet e financuara, gjë që vështirëson analizën krahasuese të plotë.

Megjithatë, përmirësimet teknologjike në platformën online dhe rritja e kapacitetit të koordinatorëve kanë lehtësuar procesin e raportimit dhe kanë bërë që shumica e institucioneve të dorëzojnë të dhëna më të sakta e të plota krahasuar me vitin 2023. Këto zhvillime dëshmojnë se trendi afatgjatë është pozitiv dhe tregon një orientim drejt një sistemi më transparent, gjithëpërfshirës dhe të besueshëm për mbështetjen e shoqërisë civile.

6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

6.1 Konkluzionet kryesore

Raporti i vitit 2024 tregon se procesi i financimit publik për OJQ-të ka shënuar përparim të dukshëm në drejtim të transparencës dhe digjitalizimit. Përdorimi i platformës online për raportim është bërë praktikë standarde për shumicën e institucioneve, duke e bërë procesin më të qasshëm për publikun dhe më të lehtë për t'u analizuar nga organet përgjegjëse. Ky hap ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e besimit dhe në lehtësimin e monitorimit publik.

Megjithatë, mbeten të pranishme disa sfida të vazhdueshme: vonesat në raportim nga një numër i vogël komunash, mungesa e standardizimit të plotë të të dhënave, si dhe raste të mos raportimit nga institucione të caktuara. Krahasimi ndër vite tregon një trend pozitiv, pasi për herë të parë niveli i raportimit ka arritur mbi 80% të institucioneve, krahasuar me përqindje më të ulëta në vitet e kaluara. Ky përmirësim është i rëndësishëm, por fakti që jo të gjitha institucionet respektojnë afatet dhe formatet e njëjta mbetet sfida për transparencën dhe harmonizimin e të dhënave.

6.2 Rekomandime për institucionet/organizatat buxhetore

Për të përmirësuar më tej procesin e financimit publik dhe raportimit, rekomandohet që institucionet:

- Të respektojnë rreptësishtë afatet e raportimit dhe të shmangin vonesat që e dëmtojnë procesin e analizës.
- Të harmonizojnë të dhënat në mënyrë që krahasimi ndër vite të jetë i plotë dhe i saktë.
- Të ofrojnë mbështetje teknike dhe trajnime për zyrtarët përgjegjës për raportim.
- Të forcojnë mekanizmat e kontrollit të brendshëm për të garantuar saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave.

6.3 Rekomandime shtesë për financimin e OJQ-ve

Për të rritur transparencën dhe përfshirjen e shoqërisë civile, rekomandohet gjithashtu që:

- Të promovohet përdorimi i platformës online si mjeti kryesor për publikimin dhe qasjen në të dhënat e financimit.
- Të zgjerohet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve publike dhe OJQ-ve në përcaktimin e prioritetëve të financimit.
- Të sigurohet një shpërndarje e fondeve më e barabartë, duke shmangur përqendrimin vetëm në disa sektorë apo rajone.
- Të zhvillohen trajnime për OJQ-të mbi aplikimin, menaxhimin dhe raportimin e projekteve të financuara nga fondet publike.
- Të inkurajohet monitorimi i pavarur nga shoqëria civile, si mekanizëm shtesë i transparencës.

6.4 Konkluzionet e përgjithshme

Raporti për vitin 2024 tregon se institucionet publike në Kosovë kanë bërë përparim të dukshëm në transparencën dhe përgjegjshmërinë e financimit të organizatave të shoqërisë civile. Për herë të parë, mbi 80% e institucioneve kanë raportuar, duke krijuar një pasqyrë shumë më të plotë të fondeve të ndara.

Në aspektin financiar, të dhënat tregojnë një dallim të qartë mes dy niveleve të qeverisjes:

- Institucionet qendrore (ZKM dhe ministritë) kanë shënuar një rritje të madhe të mbështetjes, duke kaluar nga rreth 4.3 milionë € në vitin 2023 në mbi 8.5 milionë € në vitin 2024. Kjo tregon një pothuajse dyfishim të fondeve dhe një angazhim më të madh të nivelit qendror për të përkrahur shoqërinë civile.
- Komunat, nga ana tjetër, kanë ruajtur një nivel të qëndrueshëm të financimit, duke ndarë afërsisht 6 milionë € si në vitin 2023, ashtu edhe në vitin 2024. Megjithatë nuk ka rritje të konsiderueshme në total, komunat kanë financuar më shumë projekte (967) krahasuar me nivelin qendror (682 projekte), duke treguar një shpërndarje më të gjerë dhe më të diversifikuar.

Ky kombinim i të dhënave tregon një pasqyrë interesante: niveli qendror po rrit fuqishëm mbështetjen financiare, ndërsa niveli lokal po forcon rolin e tij në aspektin sasior të projekteve. Megjithatë, mbeten sfida të dukshme si mos raportimi i disa institucioneve dhe mungesa e harmonizimit të plotë të të dhënave.

Në përfundim, trendi i vitit 2024 është pozitiv: transparenca është rritur, financimi nga niveli qendror është zgjeruar ndjeshëm, ndërsa komunat po kontribuojnë në diversifikimin e projekteve. Rekomandohet forcimi i mekanizmave të raportimit dhe rritja e koordinimit mes dy niveleve të qeverisjes, në mënyrë që ndikimi i fondeve publike të jetë më i madh, më i barabartë dhe më i ndjeshëm për komunitetet lokale.

7. ANEKSET

7.1 Lista e OJQ-ve përfituese sipas ZKM dhe ministrive

Në këtë aneks paraqiten listat e organizatave të shoqërisë civile që kanë përfituar mbështetje financiare nga Zyra e Kryeministrit dhe ministrinë përkatëse gjatë vitit 2024. Tabelat përmbajnë të dhëna për emrin e institucionit/ofruesit, periudhën e ndarjes së projektit, emrin e organizatës joqeveritare, fushën e projektit dhe shumën e ndarë. Këto të dhëna janë marrë nga raportet e dorëzuara nga institucionet përkatëse dhe pasqyrojnë mbështetjen konkrete të dhënë në nivel qendror.

Nr.	Periudha	Ofruesi	OJQ	Fusha e përgjithshme	Shuma e dhënë
1.	2024	Zyra e Kryeministrit	Advocacy Center for Democratic Culture	TË DREJTAT E NJERIUT	12.840,00 €
2.	2024	Zyra e Kryeministrit	Communication for Social Development	TË DREJTAT E NJERIUT	11.420,00 €
3.	2024	Zyra e Kryeministrit	Cult Club	TË DREJTAT E NJERIUT	9.200,00 €
4.	2024	Zyra e Kryeministrit	Dardana Press	TË DREJTAT E NJERIUT	7.490,00 €
5.	2024	Zyra e Kryeministrit	Durmish Aslano	TË DREJTAT E NJERIUT	7.600,00 €
6.	2024	Zyra e Kryeministrit	Asociacioni I Gruas-Feminae	TË DREJTAT E NJERIUT	10.800,00 €
7.	2024	Zyra e Kryeministrit	General Youth Education of Kosovo	TË DREJTAT E NJERIUT	9.300,00 €
8.	2024	Zyra e Kryeministrit	sen Dialogue Mitrovica	TË DREJTAT E NJERIUT	11.510,00 €
9.	2024	Zyra e Kryeministrit	Lady	TË DREJTAT E NJERIUT	9.400,00 €
10.	2024	Zyra e Kryeministrit	Ozon	TË DREJTAT E NJERIUT	8.200,00 €
11.	2024	Zyra e Kryeministrit	Plejada	TË DREJTAT E NJERIUT	8.740,00 €
12.	2024	Zyra e Kryeministrit	ProActive	TË DREJTAT E NJERIUT	11.900,00 €
13.	2024	Zyra e Kryeministrit	Produkcija New-Press	TË DREJTAT E NJERIUT	10.100,00 €

14.	2024	Zyra e Kryeministrit	Instituti Sink	TË DREJTAT E NJERIUT	8.200,00 €
15.	2024	Zyra e Kryeministrit	Centar za Socijalne Inicijative	TË DREJTAT E NJERIUT	13.500,00 €
16.	2024	Zyra e Kryeministrit	Centar za Depolitizaciju Kosovskog Druetva	ARSIMI, SHKENCA DHE HULUMTIMI	12.500,00 €
17.	2024	Zyra e Kryeministrit	Udruzenje za Kulturu Plejada-Prizren	TRAJNIMET TEKNIKE	9.860,00 €
18.	2024	Zyra e Kryeministrit	Omladinska Parteska Aktivnost	ARSIMI, SHKENCA DHE HULUMTIMI	12.600,00 €
				TRAJNIMET TEKNIKE	
				ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM	
19.	2024	Zyra e Kryeministrit	Choice Of Youth	TRAJNIMET TEKNIKE	13.000,00 €
				ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM	
20.	2024	Zyra e Kryeministrit	Association Stabilization Through Alternative Rights and Tolerance Kosovo eu2013 Udruzenje Stabilizacija kroz alternativu prava i toleranciju Kosovo	ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM	13.000,00 €
21.	2024	Zyra e Kryeministrit	Prosperiteti	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	8.945,00 €
22.	2024	Zyra e Kryeministrit	Media Kosovaport	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	6.000,00 €
23.	2024	Zyra e Kryeministrit	Gracanica Youth Initiatives	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	13.950,00 €
24.	2024	Zyra e Kryeministrit	Glam Radio	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	8.100,00 €
25.	2024	Zyra e Kryeministrit	Kosova Gene Birlik Dernegi/ Shoqata Unioni Rinor te Kosoves	ARSIMI, SHKENCA DHE HULUMTIMI	5.980,00 €
				SHËRBIMET SOCIALE	

				TË DREJTAT E NJERIUT	
26.	2024	Zyra e Kryeministrit	Advocacy Center for Democratic Culture	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	13.650,00 €
27.	2024	Zyra e Kryeministrit	Radio Astra	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	8.210,00 €
28.	2024	Zyra e Kryeministrit	Pontis-Ura	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	11.000,00 €
29.	2024	Zyra e Kryeministrit	Organizata joqeveritare \"Domine\"	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	8.920,00 €
30.	2024	Zyra e Kryeministrit	RONA	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	9.000,00 €
31.	2024	Zyra e Kryeministrit	Dardana Press	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	7.000,00 €
32.	2024	Zyra e Kryeministrit	Communication for Social Development	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	12.000,00 €
33.	2024	Zyra e Kryeministrit	Udrreenje za Kulturu Plejada-Prizren	TË DREJTAT E NJERIUT	8.740,00 €
34.	2024	Zyra e Kryeministrit	sen Dialogue Mitrovica	TË DREJTAT E NJERIUT	11.510,00 €
35.	2024	Zyra e Kryeministrit	Zogjë e Paqës	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	10.000,00 €
36.	2024	Zyra e Kryeministrit	Ekoloko Udrreenje OZON	TË DREJTAT E NJERIUT	8.200,00 €
37.	2024	Zyra e Kryeministrit	ProActive	TË DREJTAT E NJERIUT	11.900,00 €
38.	2024	Zyra e Kryeministrit	ProActive	TË DREJTAT E NJERIUT	11.900,00 €
39.	2024	Zyra e Kryeministrit	Advocacy Center for Democratic Culture	TË DREJTAT E NJERIUT	12.840,00 €
40.	2024	Zyra e Kryeministrit	Produkcija NEW eu2013 PRESS	TË DREJTAT E NJERIUT	10.100,00 €
41.	2024	Zyra e Kryeministrit	Communication for Social Development	TË DREJTAT E NJERIUT	11.420,00 €
42.	2024	Zyra e Kryeministrit	CENTAR ZA SOCIJALNE INICIJATIVE	TË DREJTAT E NJERIUT	13.500,00 €
43.	2024	Zyra e Kryeministrit	Instituti SINK	ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM	10.000,00 €

44.	2024	Zyra e Kryeministrit	Roma and Ashkalia Documentation Centre	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	13.000,00 €
45.	2024	Zyra e Kryeministrit	Iniciativa Rinore Aktive	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	14.425,00 €
46.	2024	Zyra e Kryeministrit	Lady	TË DREJTAT E NJERIUT	9.400,00 €
47.	2024	Zyra e Kryeministrit	START UP	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	12.500,00 €
48.	2024	Zyra e Kryeministrit	OJQ Premisa	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	13.000,00 €
49.	2024	Zyra e Kryeministrit	General Youth Education of Kosovo	TË DREJTAT E NJERIUT	9.300,00 €
50.	2024	Zyra e Kryeministrit	Unioni i Punëtoreve Social te Kosovës	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	12.000,00 €
51.	2024	Zyra e Kryeministrit	Instituti SINK	TË DREJTAT E NJERIUT	8.200,00 €
52.	2024	Zyra e Kryeministrit	Dardana Press	TË DREJTAT E NJERIUT	7.490,00 €
53.	2024	Zyra e Kryeministrit	Cult Club	TË DREJTAT E NJERIUT	9.200,00 €
54.	2024	Zyra e Kryeministrit	Asociacioni i Gruas \"Feminae\"	TË DREJTAT E NJERIUT	10.800,00 €
55.	2024	Zyra e Kryeministrit	Durmish Aslano	TË DREJTAT E NJERIUT	7.600,00 €
56.	2024	Zyra e Kryeministrit	Shoqata e te Verberve të Kosovës -SHVK		12.080,00 €
57.	2024	Zyra e Kryeministrit	Komiteti I Grave te Verbera të Kosoës-KGVK		5.000,00 €
58.	2024	Zyra e Kryeministrit	Organizata per Fëmijet pa kujdes prindor- OFAP		9.500,00 €
59.	2024	Zyra e Kryeministrit	General Youth Education of Kosovo-GYEK		11.000,00 €
				Gjithsej	608.520,00 €
60.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Ansambli i Këngëve dhe Valleve Vitia	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	12.000,00 €
61.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Ansambli i Këngëve dhe Valleve – AKV - Prishtina	FUSHAT E TJERA TË VEPRIMIT	6.500,00 €

62.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Qendra Kulturore – QK-Anamorava	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	20.000,00 €
63.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Ansambli Attacca - AAC	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	25.000,00 €
64.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Ansambli Kulturoro-Artistik-AKA Bajram Curri	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	30.000,00 €
65.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Ansambli Bresana	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	15.000,00 €
66.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	ClassiKos	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	9.000,00 €
67.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Fondacioni Shtatëmbëdhjetë	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	55.000,00 €
68.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Qendra kulturore artistike QKA “Jehona e Anadrinit”	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	14.200,00 €
69.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	SHKA Kemajl Azizi	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	8.000,00 €
70.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Fondacioni Kulturor Klarino	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	10.000,00 €
71.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Kori i Qytetit – Viti	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	6.000,00 €
72.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	"Siparantum Choir" - Pejë	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	57.000,00 €
73.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Lyra	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	8.000,00 €
74.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	N’GO	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	17.000,00 €

75.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Orkestra Frymore Prizreni	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	12.000,00 €
76.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Politeia	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	10.000,00 €
77.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Progresiva	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	10.000,00 €
78.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	ProPlus	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	20.000,00 €
79.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Qendra kulturore Kaçaniku	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	7.000,00 €
80.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	SHKA Rahoveci	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	7.000,00 €
81.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	SHKA Sharri	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	8.000,00 €
82.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Shoqata Theranada e Re	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	9.500,00 €
83.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Ansambl i Këngëve dhe Valleve Ulpiana"	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	6.500,00 €
84.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Virtuoso	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	9.400,00 €
85.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Vullnetarët e Qytetit	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	6.000,00 €
86.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Zambaku i Prizrenit	FUSHAT E TJERATË VEPRIMIT	25.000,00 €
87.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	OJQ"Anibar"	ARTI DHE KULTURA	82.000,00 €

88.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	OJQ"Art Fest"	ARTI DHE KULTURA	20.000,00 €
89.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	OJQ"Art without Limit"	ARTI DHE KULTURA	25.000,00 €
90.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	OJQ"Brez pas Brezi"	ARTI DHE KULTURA	15.000,00 €
91.	2024	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	OJQ"Dancing House "	ARTI DHE KULTURA	8.000,00 €
